



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. 746 / Prot.

Pogradec, më 10 02 .2022

Lënda: Dërgim materiali për shqyrtim e miratim.

Z.SOTIRAQ MANGËRI
KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

I nderuar Z.Kryetar,

Bashkëngjitur po iu dërgojmë projekt-vendimin dhe relacionin, për:

"MIRATIMIN ME SHKRIM PËR VAZHDIMIN E PROCEDURAVE TË HEQJES NGA FONDI PYJOR TË NJË SIPËRFAQEJE PYJORE PREJ 13.11 HA NË EKONOMINË PYJORE MOKËR 1, PËR SHFRYTËZIMIN E MINERALIT HEKUR-NIKEL, NË OBJEKTIN "RODOKALI VERIOR DHE JUGOR, ME KËRKESË TË SUBJEKTIT "MINING FERRO NIKEL" SHPK".

Me respekt,

KRYETARI

Ilir XHAKOLLI



Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 2

Nr. i faqeve të realcionit shpjegues: 7

Nr. i fletëve të dokumentave që shoqërojnë projekt-vendimin: 76



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. ____ Prot.

Pogradec, më __. __. 2022

PROJEKT VENDIM

Nr. ____, DATË __. __. 2022

PËR

MIRATIMIN ME SHKRIM PËR VAZHDIMIN E PROCEDURAVE TË HEQJES NGA FONDI PYJOR TË NJË SIPËRFAQEJE PYJORE PREJ 13.11 HA NË EKONOMINË PYJORE MOKËR I, PËR SHFRYTËZIMIN E MINERALIT HEKUR-NIKEL, NË OBJEKTIN "RODOKALI VERIOR DHE JUGOR, ME KËRKESË TË SUBJEKTIT "MINING FERRO NIKEL" SHPK.

Ligji Nr.8417, date 22.11.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, pika 1 dhe pika 2 të nenit 3 "Koncepti i autonomisë vendore" dhe nenit 4 "Rëndësia e autonomies vendore", të Ligjit Nr.8548, datë 11.11.1999 "Për ratifikimin e "Kartës Europiane të Autonomisë Vendore", pikës 2 të nenit 8, pikën 1.2 të nenit 9, pikës 5 të nenit 27 dhe gërmës "e" të nenit 54 të Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Ligji Nr.8480, datë 27.5.1999, "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", pikës 4 të nenit 5 të Ligjit Nr.57/2020, "Për Pyjet", Ligjit Nr.10304, date 15.7.2010, "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligji Nr.44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", Ligji Nr.7850, datë 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.398 datë 13.05.2020 për disa ndryshime në V.K.M Nr.433 datë 08.06.2016, "Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listës së inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe Turizmit, dhe ishkomunave/bashkive", shkronjës "ç" të pikës 5 të vendimit Nr.1353 date 10.10.2008, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e rregullave dhe për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, si dhe të kriterëve e të procedurave të zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor publik" i ndryshuar, shkresës së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit Nr.511 Prot, datë 16.01.2020 "Për përgatitje të raportit tekniko-ekonomik për kryerjen e aktivitetit minerar", Urdhëri i Kryetarit të Bashkisë Pogradec Nr.31, datë 24.01.2022, "Mbi hartimin e raportit tekniko – ekonomik, për heqjen nga fondi pyjor/kullosor në pronësi të Bashkisë", të sipërfaqes prej 13.11 Ha, në Ekonominë Pyjore Mokër I, në pronësi të Bashkisë Pogradec, "Për shfrytëzimin e mineralit të Hekur-Nikelit në objektin "Rodokali Verior dhe Jugor" nga subjekti "Mining Ferro Nikel" Shpk, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak:



VENDOSI:

1. Të miratojë vazhdimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqes prej **13.11 ha** pylli në ekonominë pyjore Moker 1, sipërfaqe e cila do ti nënshtrohet procedurave të heqjes nga fondi pyjor për ushtrimin e veprimtarisë minerare shfrytëzim hekur-nikeli, me kërkesë të subjektit **"Mining Ferro Nikel" Shpk**.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Prokurimeve Publike dhe Shërbimi Pyjor për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes publike (sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55, të Ligjit nr.139/2015 "Për vetqeverisjen vendore").
4. U shpall sot më datë __. __. 2022.

KRYETARI I KËSHILLIT TË BASHKISË
SOTIRAQ MËNGRI



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. ___ Prot

Pogradec, më __. __. 2022

RELACION
PËR PROJEKT – VENDIMIN ME OBJEKT

“PËR

DHËNIEN E DAKORTËSISË, PËR VLIJIMIN E PROCEDURAVE TË HEQJES NGA FONDI PYJOR PUBLIK TË SIPËRFAQES PYJORE PREJ 13.11 (TREMBËDHJETE PRESJE NJËMBËDHJETE) HA, E NDODHUR NË EKONOMINË PYJORE MOKËR 1, PËR SHFRYTËZIMIN ME KARIERË TË MINERALIT HEKUR-NIKEL, NË ZONËN MINERARE “RODOKALI VERIOR DHE JUGOR”, NGA SHOQËRIA “MINING FERRO NIKEL” SHPK”.

I NDERUAR KRYETAR I KËSHILLIT !

TË NDERUAR KËSHILLTARE !

Në përmbushje të detyrimeve ligjore si dhe referuar shkresës nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, po Ju dërgojmë për shqyrtim dhe marrjen e vendimit përkatës, këtë relacion, me përmbatje si më poshtë:

1. Baza ligjore:

Ligji Nr.8417, date 22.11.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, pika 1 dhe pika 2 të nenit 3 “Koncepti i autonomisë vendore” dhe nenit 4 “Rëndësia e autonomies vendore”, të Ligjit Nr.8548, datë 11.11.1999 “Për ratifikimin e “Kartës Europiane të Autonomisë Vendore”, pikës 2 të nenit 8, pikën 1.2 të nenit 9, pikës 5 të nenit 27 dhe gërmës “e” të nenit 54 të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, Ligji Nr.8480, datë 27.5.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, pikës 4 të nenit 5 të Ligjit Nr.57/2020, “Për Pyjet”, Ligji Nr.10304, date 15.7.2010, “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligji Nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Ligji Nr.7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.398 datë



13.05.2020 për disa ndryshime në V.K.M Nr.433 datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listës së inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe Turizmit, dhe ishkomunave/bashkive”, shkronjës “ç” të pikës 5 të vendimit Nr.1353 date 10.10.2008, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, si dhe të kritereve e të procedurave të zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor publik” i ndryshuar, shkresës së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit **Nr.511 Prot, datë 16.01.2020** “Për përgatitje të raportit tekniko-ekonomik për kryerjen e aktivitetit mineral”, Urdhëri i Kryetarit të Bashkisë Pogradec **Nr.31, datë 24.01.2022**, “Mbi hartimin e raportit tekniko – ekonomik, për heqjen nga fondi pyjor/kullosor në pronësi të Bashkisë”, të sipërfaqes prej **13.11 Ha**, në Ekonominë Pyjore Mokër 1, në pronësi të Bashkisë Pogradec, “Për shfrytëzimin e mineralit të Hekur–Nikelit në objektin “Rodokali Verior dhe Jugor” dhe shtojcave bashkëlidhur.

2. Proçedura e ndjekur dhe dokumentacioni i dorëzuar:

Subjekti “**Mining Ferro Nikel**” Sh.p.k është pajisur me Lejë Shfrytëzimi Minerare miratuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me **Nr.1724/1 datë 25.11.2019** për shfrytëzimin e mineraleve Hekur-Nikel Fe&Ni, që bën pjesë në grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet, me nje afat 25 vjeçar, dhe sipërfaqe prej 0.162 km² (ose 16.2 ha) e cila përfshin Zonën Minerare 220 në objektin “Katjel 2,3, Rodokal Verior dhe Jugor”, Njësia Administrative Proptisht.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit me shkresë **Nr.511 datë 16.01.2020** ka kërkuar nga Bashkia Pogradec (sektori i shërbimit pyjor), përgatitjen e raportit tekniko-ekonomik për sipërfaqet pyjore/kullosore objekt i aktivitetit mineral që do të hiqet nga fondi pyjor dhe kullosor publik.

Në zbatim të shkresës së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit Kryetari i Bashkisë Pogradec nxori Urdhërin **Nr.31 datë 24.01.2022**, “Mbi studimin tekniko-ekonomik për heqjen nga fondi pyjor për shfrytëzimin e minierës së hekur nikelit Fe&Ni, në objektin “Katjel 2,3, Rodokal Verior dhe Jugor”, i cili do të dërgohet në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit i shoqëruar me dakortësinë e Këshillit Bashkiak sipas **VKM nr. 591 dhe 592 date 9.10.2018**, “Për disa ndryshime në vendimin **Nr.1353 datë 10.10.2008 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, si dhe kritereve e të procedurave të zvogëlimit të sipërfaqes e të vëllimit të fondit pyjor” të ndryshuar.**

Sipërfaqia e lejes minerare e miratuar nga Ministria e Energjitikes dhe Industrisë është 0.162 km² ose 16.2 ha. Sipas dokumentacionit të sjelle nga subjekti dhe verifikimi në vend e ngastrave dhe n/ngastrave pyjore nga specialistet e shërbimit pyjor doli se:


- Siperfaqe pyjore me llojin lis qe do të hiqet nga fondi pyjor është 5.730 ha
 - Siperfaqe inproduktive 7.380 ha
- Totali-13.11 ha**



Leja minerare me sipërfaqe **0.162 km²** e Shoqërisë "Mining Ferro Nikel" Sh.p.k shtrihet në dy Bashki, në Bashkinë Pogradec dhe atë Përrenjas, ku **3.1 ha** ndodhen në Bashkinë Përrenjas ku është dhënë dakortësia me Vendim Këshilli Bashkiak për sipërfaqen **3.1 ha** që Bashkia Përrenjas administron dhe **13.11 ha** në Bashkinë Pogradec.


HARTA PYJORE

Ekonomia pyjore Mokër 1-Vendosja e konturit të lejes minerare





Harta Topografike dhe vendosja e konturit të lejes Minerare





Subjekti "Mining Ferro Nikel" Sh.p.k kryen veprimtarinë e tij në karrierat në sipërfaqet pyjor me llojin pyjor lis dhe sipërfaqet inproduktive sipas raportit teknik dhe projektit të shtrirjes së blloqeve të mineralit në sipërfaqe pyjore është e detyrueshme heqja e kësaj sipërfaqeje nga fondi pyjor sipas ligjit.



Foto të realizuara në objektin ku ushtohet aktiviteti minerar



Subjekti "Mining Ferro Nikel" Shpk, me NIPT L31929015F ka Akt-Miratimi leje Mjedisore të **Tipi B** për veprimtarinë, **Karriere e mineralit hekur nikel "Fe&Ni"** të lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, për shfrytëzimin 25000 ton/vit, kapaciteti i projektuar me numur indentifikimi të lejes **Nr.2746 datë 21.02.2018**.

Shoqëria "Mining Ferro Nikel" Sh.p.k ka paguar garancinë financiare të rehabilitimit të mjedisit për periudhën 25.11.2021-25.11.2022, në institucionin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në vlerën 467460 lek.

Subjekti ka paguar detyrimet në Drejtorinë e përgjithshme të tatimeve në kohë reale për vitin 2021.

Subjekti "Mining Ferro Nikel" Sh.p.k ka paraqitur dhe Raportin e vete monitorimit Mjedisor për periudhën 18.08.2020-18.02.2021.

Vendimi i Këshillit Bashkiak Përrenjas Nr.41 datë 20.08.2021 "Për miratimin dhe dhënien e dakortësisë për vijimin e procedurave për heqje nga Fondi Pyjor/kullosor publik të Shoqërisë "Mining Ferro Nikel" Sh.p.k me sipërfaqe 0.031 km² ose 3.1 ha.

Ne lidhje me rehabilitimin e sipërfaqeve që do të dëmtohen nga shfrytëzimi dhe ajo që hiqet nga fondi pyjor sipas urdhërit të Ministrisë së Mjedisit **nr.10229 dt.21.10.2014 "Mbi percaktimin e detyrimit të subjekteve për të zëvendësuar sipërfaqet pyjore dhe përmirësuar siperfaqet kullosore që hiqen nga fondi pyjor e kullosor nëpërmjet pyllëzimit, ripyllëzimit dhe përmirësimit të tyre" gjithë siperfaqja që do të hiqet do të pyllezohet me lloje pyjore.**

Rehabilitimi i karrierave të shfrytëzimit të mineraleve dhe guroreve do të nështrohet zbatimit të urdhërit të Ministrisë së Mjedisit dhe Ministrisë së Energjitikës nr. 67 datë 11.03.2018 Për miratimin e planit të veprimit për veprimtaritë minerare me karriere (Guroret).

3. Bashkëlidhur relacionit i bashkëngjiten dokumentat e mëposhtëme:

- ✓ Kërkesa e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit drejtuar Bashkisë Pogradec "për vijimin e procedurave për heqjen nga fondi pyjor", nr.511 datë 16.01.2020.
- ✓ Urdhëri i Kryetarit të Bashkisë nr.31 datë 24.01.2022 "Për hartimin e raportit Tekniko – Ekonomik për heqjen nga Fondi Pyjor/ Kullosor në pronësi të Bashkisë Pogradec",
- ✓ Vendimi i Këshillit Bashkiak Përrenjas Nr.41 datë 20.08.2021 për sipërfaqen 0.031 km².
- ✓ Fatura e Garancisë Financiare të Rehabilitimit të Mjedisit.
- ✓ Vërtetimi që ka paguar detyrimet.
- ✓ Leja Minerare
- ✓ Leja mjedisore
- ✓ NIPT
- ✓ Vendimi nr.1353 date 10.10.2008 arzhonuar me vkm nr.434 date 8.06.2016
- ✓ Vendimi nr.591 datë 9.10.2018 "Per disa ndryshime ne vkm nr.1353 datë 10.10.2008".
- ✓ Raporti i Vete Monitorimit Mjedisor për periudhën 18.08.2020-18.02.2021.
- ✓ Miratimi programit vjetor nga AKBN.
- ✓ Hartat e siperfaqeve sipas lejes minerare



Duke shpresuar në miratimin e këtij materiali nga ana Juaj,

PËRGATITI MATERIALIN:

Konceptuan:

Inxhinier Pyjore:

Ing. KLEDI LUFO

Specialist:

EDLIR PILINÇI

Pranoi:

PËRGJEGJËS SEKTORI

Ing. ARBEN BRAHO

Miratoi:

DREJTORI N.M.I.P.P

ENTON BERBERI

Konfirmoi:

KRYETAR

ILIR XHAKOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
NDËRMARRJA E MIRËMBAJTJES SË INFRASTRUKTURAVE DHE PUNËVE
PUBLIKE

RAPORT

MBI STUDIMIN TEKNIKO-EKONOMIK

PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR TË SIPËRFAQES PREJ 13.11 HA, NË EKONOMINË PYJORE MOKËR I NË PRONËSI TË BASHKISË POGRADEC “PËR SHFRYTËZIMIN E MINERALIT TË HEKUR-NIKELIT FE&NI NË OBJEKTIN “KATJEL 2,3, RODOKALI VERIOR DHE JUGOR”.

NGA SUBJEKTI “MINING FERRO NIKEL” SHPK.

Bazuar në shkresën e Ministrisë së Mjedisit dhe Turizmit, dërguar Bashkisë Pogradec me **Nr.511 prot, datë 16.01.2020** “Për vlerësimin tekniko-ekonomik të sipërfaqes pyjore/kullosore objekt për kryerjen e aktivitetit minerar për shfrytëzimin e mineralit të hekur-nikelit në objektin “Rodokali Verior dhe Jugor”, **Urdhërit Nr.31 datë 24.01.2022** i Kryetarit të Bashkisë Pogradec, grupi i punës i përbërë nga **Arben BRAHO** përgjegjësi sektorit të shërbimit pyjor, **Ing.Kledi LUFO** specialist i përgjithshëm i Pyjeve dhe Kullotave, **Edlir PILINCI** specialist i përgjithshëm i Pyjeve dhe Kullotave, nga data **24.01.2022-31.01.2022**, studjoi kërkesën e subjektit “**Mining Ferro Nikel**” **Sh.p.k.**, dhe realizoi verifikimin në terren dhe në regjistrin kadastral të sipërfaqeve pyjore, me objekt për heqjen nga fondi pyjor publik.

Mbështetur në të dhënat e regjistrit kadastral pyjor/kullosor rezulton që sipërfaqia e kërkuar është **13.11 ha** dhe shtrihet në n/ngastrat **3a, 3b**, të cilat bëjnë pjesë në ekonominë pyjore Mokër 1, në pronësi dhe administrim të Bashkisë Pogradec.

Përshkrimi parcellar i sipërfaqes objekt studimi dhe kategoria e përdorimit, pasqyrohen në tabelën 1 dhe 2 të këtij raporti.

Nga verifikimi në terren rezulton kjo gjëndje: *(lexo tabelat përkatëse 1 dhe 2)*

Ndërhyrjet e propozuara që pasqyrohen në dokumentacionin e paraqitur nga subjekti “**Mining Ferro Nikel**” **Sh.p.k.**, ndryshojnë kategorinë e përdorimit të territorit, funksionin, formën e qeverimit dhe treguesit kryesor të grumbullit, në ngastrat **3a-5.730 ha, 3b-7.380 ha**, dhe pakson volumin në **118.61 m³** dru zjarri të llojit lis në ngastrat e mësipërme, në ekonominë pyjore Mokër 1.



Procedurat që ndiqen për heqjen nga fondi pyjor dhe kullësor publik janë të mbështetura në VKM –në nr.1353, datë 10.10.2008, të ndryshuar “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të

Vëllimit të fondit pyjor” në VKM-në Nr.1374, datë 10.10.2008, të ndryshuar “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullësor, “Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit Nr.1 datë 9.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor e kullësor publik”.

Pas miratimit të raportit tekniko-ekonomik dhe akteve të tjera normative si më sipër, shoqëria kryen aktivitetin për sipërfaqen e shpallur, vetëm pas likuidimit të tarifës prej **73805 lek (Shtatëdhjete e tre mij e tetëqind e pesë lek)**.

Tarifat e heqjes nga fondi pyjor bazohen në VKM-në Nr.391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, të ndryshuar me VKM-në, Nr.1064, datë 22.12.2010. “Për disa ndryshime në vendimin numur 391 datë 21.06.2016 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” bazohet në afatin kohor sipas grafikut të punimeve të miratuar nga institucioni përkatës dhe kategorinë e përdorimit.

Shuma në lekë konsiston në:

Vlerën e bimësisë pyjore, florës dhe faunës = 73805 lekë, e përbërë nga:

Vlera e lëndës së punimit = 0 lekë

Vlera e drusë se zjarrit = 59305 lekë

Vlera e prodhimeve të dyta pyjore = 0 lekë

Bimet medicinale = 10000 lekë

Vlera e faunës = 4500 lekë

Vlera e investimeve të kryera (pyllëzime, zëvendësime, përmirësime, etj) = 0 lekë

Të tjera: **Tarifë shërbimi për hartimin e raportit teknik = 20000 lekë**

PËRPILUESIT E RAPORTIT TEKNIKO-EKONOMIK

Ing. Kledi LUFU

Edlir PILINCI

Ing. Arben BRAHO

DREJTORI I NDËRMARRJES MIRËMBAJTJES SË INFRASTURUKTURAVE DHE PUNËVE
PUBLIKE

Enton BËRBERI

MIRATOI

KRYETARI I BASHKISË

ILIR XHAKOLLI

BASHKIA POGRADEC
 NDËRMARRJA E MIRËMBAJTJES SË INFRASTRUKTURAVE DHE PUNËVE PUBLIKE
 SEKTORI I SHËRBIMIT PYJOR



PASQYRA E PËRSHKRIMIT PARCELAR SIPAS REGJISTRIT KADASTRAL
 PËR HEQIEN NGA FONDI PYJOR TË SIPËRFAQËS PËR SHFRYTËZIMIN E MINERALIT HEKUR-NIKEL NË ZONËN
 MINERALE "RODOKALI VERIOR DHE JUGOR".

Tabela nr.1

ID	Ekonomia pyjore	Parcela	Përberja e grumbullit	Funksioni	Forma e qeverisjes	Të dhëna për grumbullin pyjor						Katet	Fuga lëndore m ³ Per/ha	Total
						Mosha	Kd	D.Mesatar	h/mesat	Filizeria	N/pylli			
KO49 0 003	Moker 1	3a	100 lis	Prodhues	Cungishte	15vjet	0.7	3cm	3m	Mungon	D.Kuqe, Muz	N	11.16	104.0
KO49 0 003	Moker 1	3b	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Shuma:														63.94

PASQYRA E PËRSHKRIMIT PARCELAR SIPAS VERIFIKIMIT NË TERREN
 PËR HEQIEN NGA FONDI PYJOR TË SIPËRFAQËS PËR SHFRYTËZIMIN E MINERALIT HEKUR-NIKEL NË ZONËN
 MINERALE "RODOKALI VERIOR DHE JUGOR".

ID	Ekonomia pyjore	Parcela	Përberja e grumbullit	Funksioni	Forma e qeverisjes	Të dhëna për grumbullin pyjor						Fuga lëndore Per/ha	Total	
						Mosha	Kd	D.Mesatar	h/mesat.	Filizeria	N/pylli			D.Zeze
KO49 0 003	Moker 1	3a	100 lis	Prodhues	Cungishte	20	0.7	6	3	Filizeria Ekziston	N/pylli D.Zeze	N	20.7	118.61
KO49 0 003	Moker 1	3b	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Shuma:														118.61

Plotësoi: Ing.Kledi LUFO

Editr PILLINCI

DREJTORI I NMIPP
 Enton BERBERI

Përgjegjësi i Sektorit
 Arben BRAHO

BASHKIA POGRADEC
 NDËRMARRJA E MIRËMBATJES SË INFRASTRUKTURAVE DHE PUNËVE PUBLIKE
 SEKTORI I SHËRBIMIT PYJOR



INVESTITIME TË KRYERA NË VITE
 OBJEKTI "RODOKALI VERIOR DHE JUGOR".

Tabela nr.3

ID Prontë	Përdorimi pyjorë	Ekonomia pyjore	Parcela 3a 3b	Sip. totale në/ha	Sip. me punime/ha	Viti kryerjes punimeve	Punime të kryera			Vlera e investimit 000/leke
							Pyllëzime ha	Përrindësimë ha	Sisteminime Malore m3	
KO49 0 003	Pyll	Mokër 1	3a	5.730	-	-	-	-	-	-
KO49 0 003	Improduktive	Mokër 1	3b	7.380	-	-	-	-	-	-
Shuma:				13.11						

Plotesoi: Ing Kleth LULO

Editor PILLINCI

DREJTORI NMIPP

Entiteti BRBERI

Përgjegjësi i Sektorit

Arben BRAHO

BASHKIA POGRADEC
 NËRMARJA E MIRËMBATJES SË INFRASTRUKTURAVE DHE PUNËVE PUBLIKE
 SEKTORI I SHËRBIMIT PYJOR

TABELA PËRMIRLEDHËSE E VLERËSIMIT FINANCIAR

TË SIPERFAQES PËR SHRYTËZIMIN E MINERALIT HEKUR-NIKEL NË ZONËN MINERALE "RODOKALI VERIOR DHE JUGOR", NGA SHOQËRIA "Mining Ferro Nikel"Shpk.

Tabella nr.4

Përdorimi territorit	Sipërfaqja	Bashkia	Volumi sipas asortimenteve	Vlera sipas asortimenteve		Gjatesia e përdorimit km	Tarfja e dëbjes ne përdorim Leke/km/vit			Shuma e II-te	Totali: Shuma e I+II-te
				Dru zjarri Leke/m3	Shuma e I-re		I	2deri ne 5	6-10vjet		
Trangishte	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*
Cungishte	5.730	Pogradec	118,61	500	59305	*	*	*	*	*	59305
Shkurre	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*
Bimesi pyjore/djert	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*
Inproduktive	7.380	Pogradec	*	*	*	*	*	*	*	*	-
Bime mjekesore/medicinale	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*
Gjoetia	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	10000
Investime te realizuara	*	*	*	*	*	*	*	*	*	*	4500
Totali:	13,11	-	118,61	-	59305	-	-	-	-	-	73805

Plotësoi: Ing. Klodi LUPO



Edlir PILINCI



DREJTORI I NMIPP
 Enton BERBERI



Përgjegjësi i Sektorit
 Arben BRAHO



BASHKIA POGRADEC
NDËRMARRJA E MIRËMBALJTJES SË INFRASTRUKTURAVE DHE PUNËVE PUBLIKE
SEKTORI I SHËRBIMIT PYJOR



LISTA E NGASTRAVE DHE N/NGASTRAVE QË HIQEN NGA FONDI PYJOR DHE KULLOSOR PUBLIK
TE SIPËRFAQËS PËR SHFRYTËZIMIN E MINERALIT HEKUR-NIKEL, NË ZONËN MINERARE "RODOKALI VERIOR DHE
JUGOR".

Tabela nr.5

ID Prones	Ekonomia pyjore	Ngastra n/ngastra	Sip. që do hiqet nga Fondipyjor/kulllosor ne/ ha	Sipërfaqja qe jepet ne përdorim nga fondi pyjor/kulllosor ne/ ha	Gjatësia në përdorim /km		
					Rrugë	Linjë	Tubacion kanal
KO49 0 003	Moker 1	3a	5.730	-	-	-	
KO49 0 003	Moker 1	3b	7.380	-	-	-	
Shuma:			13.11	-	-	-	

Plotesoi: Ing. Kledi LUFQ

Editor PILLINCI

DREJTORI I NMIPP
Enton BERBERI

Përgjegjësi i Sektorit
Arben BRAHO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
NDËRMARRJA E MIRËMBAJTJES SË INFRASTRUKTURAVE DHE PUNËVE PUBLIKE
SEKTORI I SHËRBIMIT PYJOR

Nr. 423 prot.

Pogradec, më 24.01. 2022

URDHËR

NR. 31, DATË 24.01. 2022

MBI



**HARTIMIN E RAPORTIT TEKNIKO-EKONOMIK, PËR HEQJEN NGA
FONDI PYJOR/KULLOSOR NË PRONËSI TË BASHKISË**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 27 pika 5 të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqëverisjen vendore", i ndryshuar, nenit 5 pika 4 të Ligjit Nr. 57/2020, "Për pyjet", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.1353, datë 10.10.2008, "Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.433, datë 08.06.2016, "Për transferimin sipas listës së inventarit të pyjeve dhe kullotave publike, aktualisht në administrimin e Ministrisë së Mjedisit në pronësi të ish komunave/bashkive", Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.1064, datë 22.12.2010, "Për tarifat", i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.22 date 09.01.2008 "Per percaktimin e procedurave dhe kriterëve të Administrimit të pyllit Komunal, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.510, date 10.06.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara e të patrupëzuara", *si dhe referuar shkresës së Ministrisë së Turizimit dhe Mjedisit Nr.511 prot. datë 16.01.2020, "Për përgatitje të raportit tekniko-ekonomik për kryerjen e aktivitetit mineral", e protokolluar pranë Bashkisë Pogradec Nr.154/1 prot datë 16.01.2020,*

URDHËROJ:

1. Të ngrihet grupi i punës për hartimin e raportit tekniko - ekonomik për heqjen nga fondi pyjor/kullosur, për sipërfaqet në përdorim të subjektit "**Mining Ferro Nikel**" SHPK, zotërues i lehtës minierare të shfrytëzimit me Nr.1724/1, datë 25.11.2019, për shfrytëzimin e mineralit FE-NI, në objektin "Katjel 2, 3, Rodokal Verior e Jugor", Pogradec, me përbërje si më poshtë:

1.1 Arben BRAHO	Përgjegjës Sektori	"Kryetar"
1.2 Edlir PILINÇI	Specialist i Pyjeve	"Anëtar"
1.3 Kledi LUFO	Specialist për Pyjet dhe Kullotat	"Anëtar"



2. Vlerësimi tekniko-financiar të realizohet duke u bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.1353, datë 10.10.2008, "Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor", Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.391 datë 21.06.2006, "Për percaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", e ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.1064, datë 21.12.2010, sipas formatit të dërguar me shkresën nr.7396 prot, date 9.11.2020.

3. Sipas Udhëzimit të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr.01 datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor/kullosor publik".

4. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohen grupi i punës sipas pikave 1.1 - 1.3.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.



KRYETAR
Ilir XHAKOLLI

Nr. kopje: 5 (Pesë)



N.M.I.P.P.
 Nr.Prot. 58
 Dt. 20.01.2020

Sektor N.1
 Pyetje
 J. J. J. J. J.

POGRADEC
 135/1
 16.01.2020

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TË
MJEDISIT

Nr. 511 prot.

Tiranë, më 16.01 2020

Lënda: Për përgatitje të raportit tekniko-ekonomik për kryerjen e aktivitetit minerar

Drejtuar: **BASHKISË POGRADEC**
BASHKISË PRRENJAS

Për dijeni: **SHOQËRISË " MINING FERRO NIKEL" sh.p.k.**
Miniera e Hekur Nikelit KATJEL, Lagja "Dervishi",

PRRENJAS

Shoqëria "Mining Ferro Nikel" sh.p.k., ka bërë kërkesë pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për heqjen nga fondi pyjor e kullësor publik të sipërfaqes për kryerjen e aktivitetit minerar për shfrytëzimin e hekur-nikelit në objektin "Katjel 2, 3, Rodokal Verior e Jugor", në bashkitë Pogradec dhe Prrenjas, sipas lejes minerare nr.1724/1, datë 25.11.2019, të miratuar nga MIE.

Bazuar në Ligjin nr.48/2016 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9385, datë 4.05.2005 "Për pyjet dhe Shërbimin Pyjor", të ndryshuar"; në VKM nr. 1353, datë 10.10.2008 "Për përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, si dhe të kritereve e të procedurave të zvoglimit të sipërfaqes e të vëllimit të fondit pyjor", të ndryshuar; në VKM nr. 1374, datë 10.10.2008 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullësor", të ndryshuar; në VKM nr.433, datë 8.06.2016 "Për transferimin sipas listave të inventarit të pyjeve dhe kullotave publike, aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe ish komunave/bashkive, në pronësi të bashkive"; në Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit nr.1, datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik", nga ana e strukturës përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki, kërkohet përgatitja e raportit tekniko-ekonomik për sipërfaqet



Një kopje e dokumentacionit të përgatitur dërgohet pranë Ministrisë Turizmit dhe Mjedisit për vijimin më tej të procedurave të heqjes nga fondi pyjor dhe kullosor dhe pakësimin në volum.


Dërgimi i raportit tekniko-ekonomik duhet të shoqërohet dhe me dakortësinë e Këshillit të Bashkisë, sipas përcaktimit në pikën 2/b të V.K.M. nr.591 dhe 592, datë 9.10.2018.

Bashkëngjitur gjeni dokumentacionin ligjor dhe teknik.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM


Adrian KAMENICA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
MINISTRI

Nr. 2958/12 prot.

Tiranë, më 25.11.2019

Lënda: Akt – Miratimi mbi kërkesën me numër çështje, LC – 3864 – 12 – 2018.

QENDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT

Blv: " Zhan D`Ark", Pranë Ministrisë së Jashtme, Tiranë.

AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE

" Blloku Vasil Shanto ", NR.18, Tiranë.

SHËRBIMIT GJEOLGJIK SHQIPTAR

Rruga: " Myslym Keta", Tiranë.

Bashkëlidhur po ju dërgojmë Akt – Miratimin Nr.1724/1, për shndërimin e lejes minerare të kërkim – zbulimit, sipas akt – miratimit nr.1724, datë 03.11.2012, në leje minerare shfrytëzimi për mineralin Fe-Ni, që bën pjesë në grupin e mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet, për objektin " Katjel 2,3, Rodokal Verior dhe Jugor ", Librazhd, Qarku Elbasan.

Ky Akt - Miratimi shoqërohet me aktin e verifikimit të AKBN, për shndërimin e lejes minerare të kërkim – zbulimit në leje shfrytëzimi, vlerësimin për kushtet e lejimit, oponencën e projektit të zhvillimit të veprimtarive minerare të shfrytëzimit, dhe Vendimin e Këshillit Teknik të AKBN, Nr.532 datë 10.03.2017, (Nr.2268 prot MIE dt 12.04.2017 dhe nr.3032 prot AKBN dt 10.04.2017), rishqyrtuar me VKT Nr.715, datë 27.02.2019, (nr.2958, prot MIE dt 11.03.2019)

Faleminderit për bashkëpunimin.

MINISTRI

Belinda Balluku


Me Autorizim

ZËVENDËSMINISTRI

Ilir Bejtja



Leja Minerare Nr.1724/1



MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
 DREJTORIA E PROGRAMEVË TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN E MINIERAVE DHE INDUSTRIË
 OBJEKTI "Kupjet 2, 3, Radokali verior dhe jugor", Lërëzat, Qarku i Elbasanit

Leja nr: Leja Nr.1724/1
 Shtetësi: "Mining Ferro Nickel" sh.p.k
 Muesori: Hekur Nikeli
 Lloji i kësaj: Shpirtëzimi
 Sipërfaqja: km² 0,162

Pika	Kordinatat			Pika	Kordinatat		
	X	Y	Pika		X	Y	
1	4544990	4463370	20	4542941	4463015		
2	4544525	4463460	21	4542957	4462943		
3	4544607	4463405	22	4542900	4462858		
4	4544700	4463300	23	4542398	4463004		
5	4544760	4463220	24	4542100	4462568		
6	4544180	4463000	25	4542100	4462709		
7	4543795	4463118	26	4542300	4462843		
8	4543795	4463181	27	4542757	4462944		
9	4543725	4463181	28	4542393	4463025		
10	4543725	4463116	29	4543350	4463130		
11	4543325	4463144	30	4543725	4463098		
12	4543084	4463086	31	4543795	4463090		
13	4543113	4463160	32	4544100	4462980		
14	4542954	4463181	33	4544700	4463200		
15	4542892	4463159	34	4544800	4463300		
16	4543074	4463085	35	4544800	4463300		
17	4542792	4463040	36	4544720	4463300		
18	4542756	4463111	37	4544625	4463395		
19	4542680	4463077	38	4544695	4463500		



data: 30.03.2019
 Muesori: Hekur Nikeli

4462000 4463000 4464000 4465000

sipërfaqeve të lejeve minerare sipas programit të veprimit, dhe jo më e madhe se 10 (dhjetë)km². Zona e lejuar minerare për realizimin e veprimtarisë së shfrytëzimit është përshkruar në hartën që bashkëngjitet këtij akt - miratimi, firmoset nga Ministri ka vulën e MIE dhe është pjesë e tij.

5. Përfituesi i lejes minerare të shfrytëzimit është i detyruar të respektojë kërkesat e ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, *Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë*, dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij; si dhe kërkesat e legjislacionit mjedisor apo legjislacioneve të tjera të Republikës së Shqipërisë që lidhen me operacionet e punës së tij gjatë veprimtarisë minerare të shfrytëzimit të mineraleve, për të cilët i është dhënë kjo leje. Në mënyrë të specifikuar kërkohet respektimi i afateve ligjore për rastet kur zotëruesi i lejes së shfrytëzimit kërkon të ndërpresë veprimtarinë e prodhimit në zonën e lejuar ose ta pezullojë përkohësisht veprimtarinë e shfrytëzimit në zonën e lejuar.
6. Përfituesi i lejes minerare brenda afatit të miratuar të lejes minerare të shfrytëzimit duhet të realizojë programin e investimit vjetor dhe atë të investimit total sipas përcaktimeve të tabelës së mëposhtme:

Periudhat e punës sipas viteve të punës	Aktivitetet	Shpenzimet për programin e investimit
Periudha, (viti i parë max)	Studime e projektme, blerje makineri e pajisje, rruge, sheshe, sistemime, ndërtim – montime zyrash, objekte te infrastrukturës, mure mbajtës, ndërtesa, automjete e aksesore.	17 327 000 lekë
TOTALI	Studime e projektme, blerje makineri e pajisje, rruge, sheshe, sistemime, ndërtim – montime zyrash, objekte te infrastrukturës, mure mbajtës, ndërtesa, automjete e aksesore.	135 542 000 lekë nga këto të reja, 74 458 000 lekë.

7. Veprimtaria minerare e shfrytëzimit për realizimin e programit të investimit (shpenzimet e planifikuara) do të përmbajnë këto operacione pune; Hapja e vendburimit (Studime, projektme, blerje makineri e pajisje, rruge sheshe, sistemime, ndertim – montime, ndertim zyrash dhe objekte te infrastrukturës për venien ne punë të objektit, me një vlere totale prej (135 542 000 lekë), nga të cilat të reja; janë 74 458 000 lekë.
Afati fillestar i marjes se lejes minerare te shfrytëzimit eshte 25 (njëzetepesë) vjet.

Veprimtaria minerare e shfrytëzimit gjate periudhës fillestare te lejes minerare sipas projektit te zhvillimit te veprimtarise minerare do te realizoje:

- Prodhim minerali ne total, 158 845 ton me 0.95% Ni
- Prodhim max minerali ne vit, 50 000 ton me 0.95% Ni





sigurimin e mjeteve mbrojtëse individuale për punonjësit, sigurimin e paketës mjekësore të domosdoshme për ndihmën e parë në rastë nevojë si dhe gjatë gjithë kohës duhet të mbajë në gadishmeri makine transporti në gjendje pune.

d) Data efektive e lejes minerare të shfrytëzimit është data e publikimit në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve, të Qendrës Kombëtare të Biznesit.

e) Përfituesi i kësaj leje duhet të respektojë përmbushjen në afat dhe me korrektësi të detyrat e lëna nga strukturat përgjegjëse mbikëqyrëse e monitoruese të përcaktuara sipas ligjit nr.10304, datë 15.07.2010 "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë" dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

- Çdo njoftim ose komunikim tjetër i kërkuar ose i dhënë në lidhje me këtë leje ka vlerë legale nëse është dorëzuar me shkrim dhe është dërguar me postë ose me fax. pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit ose :

MINISTRIT zotit _____

i. me postë: ADRESA; Rruga " Abdi Toptani", Nr.1, Tiranë, Shqipëri

ii. me fax: Nr.

ZOTËRUESI I LEJES SHFRYTËZIMIT

- h. ZOTËRUESIT TË LEJES SHFRYTËZIMIT zotit; znj. Sibe Azemi
i. Shoqërisë: "MINING FERRO NIKEL " sh.p.k
j. me postë : Elbasan, Përrenjas, "Miniera e hekur nikelit", Katjel, Lagjia " Dervishi" brenda ambjentëve të Minierës.
k. ii. me fax: Cel; 069 58 22 735.

MINISTRI I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

* Shënim:

Në rastin kur zotëruesi i lejes ndryshon, ose nuk është aksioner i shumicës së zotërimit të aksioneve/ kryesor maxhoritar kalimi i të drejtave të lejes minerare të shfrytëzimit tek zotëruesi i ri bëhet në përputhje me kërkesat e VKM nr.362, datë 29.04.2011 "Për miratimin e kriterëve dhe rregullave të transferimit, mënyrës së aplikimit për shtyrjen e afateve dhe shndërrimit të lejeve minerare".

Në rastin kur zotëruesi i lejes ndryshon, administratorin e shoqërisë, apo drejtuesin teknik, zotëruesi i lejes së shfrytëzimit duhet të specifikojë emrat, adresat dhe interesin përkatës të personit apo entit përgjegjës për drejtimin e operacioneve në zonën e lejuar duke njoftuar 10 (dhjetë) ditë kalendarike më parë me shkrim Ministrin për realizimin e këtij ndryshimi.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT



MINISTRI

BLENDI KËOSI

Datë 21.2.2018

Nr. 1461 Prot

Nr.i identifikimit të Lejes 2746

K.Nr.05

AKT MIRATIMI
Leje Mjedisi Tipi B

Në mbështetje të Ligjit Nr. 10448, datë 14.07.2011 "Për Lejet e Mjedisit", Ligji Nr. 10 431, datë 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit", dhe në zbatim të tyre, pas shqyrtimit të kërkesës për Leje Mjedisi, Agjencia Kombëtare e Mjedisit jep mendimin për miratimin e lejes me argumentimet bashkëngjitur për kërkuuesin si më poshtë.

1. Personi juridik: MINING FERRO NIKEL Sh.p.k (LC – 5063)

1.2 Nr. Nipt: L31929015F

1.3 Adresa: "Miniera e hekur nikelit", Katjel, Lagjia "Dervishi", Prrenjës, Elbasan.

1.4 Personi përgjegjës: Sibe Azemi

2.1 Titulli i instalimit: Nxjerrja e mineraleve, rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guoret.

2.2 Përshkrimi i veprimtarisë dhe kapacitetit prodhues: Nxjerrja e mineraleve, rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guoret. Kapaciteti i projektuar për shfrytëzim është 25 000 ton/vit. Sipërfaqja e zonës së kërkuar është 0.159 km²

3. Vendndodhja: Objekti "Katjel 2,3 dhe Rodokali verior e jugor", Qyteti Prrenjës, Elbasan.

Vlefshmëria e kësaj leje fillon menjëherë nga data e miratimit të saj.



Përmbajtja

Kushti	1	Objekti
Kushti	2	Menaxhimi i Instalimit
Kushti	3	Funksionimi dhe Infrastruktura
Kushti	4	Plani i përputhshmërisë
Kushti	5	Interpretimi
Kushti	6	Njoftimet
Kushti	7	Shkarkimi
Kushti	8	Menaxhimi i Mbetjeve
Kushti	9	Zhurma
Kushti	10	Lëndët e para dhe përdorimi i energjisë
Kushti	11	Monitorimi
Kushti	12	Dokumentimi dhe raportimi tek autoriteti kompetent
Kushti	13	Incidentet dhe veprimet gjatë emergjencave
Kushti	14	Çmontimi, rehabilitimi dhe kontrolli pas ndërprerjes së operacioneve



KUSHTI 1 – OBJEKTI

1.1. Kjo Leje dhe kushtet e përcaktuara në të jepen për veprimtaritë dhe kapacitetet e përcaktuara në kapitullin 2-4 të kërkesës për këtë leje, ose e modifikuar sipas kushteve të kësaj Leje. Operatori është i autorizuar të zhvillojë veprimtaritë dhe/ose veprimtaritë shoqëruese siç specifikohen në Tabelën 1.1.1 dhe 1.1.2.

Veprimtaria sipas Shtojcës 1 të Ligjit Nr. 10448, datë 14.07.2011 "Për Lejet e Mjedisit"	Përshkrim i veprimtarisë së specifikuar	Kapaciteti kufi i veprimtarisë së specifikuar
Industria minerare 3.7	Nxjerrja e mineraleve, rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret.	Të gjitha instalimet Kapaciteti i projektuar 25 000 ton/vit mineral (Hekur Nikel)



	<p>Hapja e transhese prerese (pergatitore) Permasat e seksionit terthor, gjeresia e bazes se transhese percaktohen nje lloj si transhete kapitale me vecori se lartesia e tyre varet nga lartesia e shkalles dhe pjerresia pranohet nga 3 - 5 o/w qe siguron rrjedhjen e ujrave jashte shesheve te punes. Kendi i pjerresise se faqeve te transhese prerese percaktohet:</p> <p>Punimet e zbulimit Shkembinjte qe higen per te zbuluar mineralin e dobishem perbejne mbulesen, ndersa punimet qe kryhen per heqjen e tyre quhen punime zbulimi. Sasia e shkembinjve qe duhen levizur per te shfrytezuar 1 mu mineral te dobishem eshte koeficienti i zbulimit. Madhesia e tij varet nga kushtet gjeologo-minerare te shtrirjes se vendburimit, sistemi i shfrytezimit, vlera e mineralit te dobishem. Shfrytezimi i vendburimit perfshin disa faza : Proceset kryesore ne kryerjen e punimeve te zbulimit jane : rezimi, ngarkimi, transporti dhe stivimi i shkembinjve.</p> <p>Rrezimi konsiston ne zhvendosjen e mases se shkrfetuar te mineralit te dobishem nga masivi dhe shkrfetimin e tij, i cili realizohet me ndihmen e punimeve te shpim-rrezimit</p> <p>Ngarkimi konsiston ne zhvendosjen e mases se shkrfetuar te mineralit te dobishem ose shkmbit me ane te mekanizmave te ngarkimit si ekskavatore fadroma, varinska etj.. ne mjetet e transportit.</p> <p>Transporti konsiston ne zhvendosjen e shkembinjve ne stiva dhe mineralit te dobishem ne stiva ose ne destinacion. Shfrytezimi i mineralit ne sipërfaqe do te jete ekonomik deri ne ate thellesi, ne te cilen kostoja e plote e njesise se mineralit te nxjerre te jete me e vogel ose e barabarte me koston e shfrytezimit me nentoke. Kjo thellesi e shfrytezimit ne sipërfaqe quhet kufitare ose racionale. Thellesia ekonomike e shfrytezimit ne sipërfaqe kufizohet nga rritja e koeficientit te zbulimit.</p>
--	---

- 1.2. Operimi, kontrolli, mirëmbajtja e instalimit dhe shkarkimet nga instalimi duhet të kryhen vetëm në përputhje me kushtet e kësaj Leje. Të gjitha programet, planet dhe dokumentet e tjera që do të gjenerohen si rezultat i kësaj Leje do të jenë pjesë përbërëse e saj.
- 1.3. Ndryshimet në lidhje me funksionimin dhe ndryshimet e konsiderueshme në lidhje me instalimin, që mund të çojnë në një ndryshim në natyrën e shkarkimeve ose rritje të tyre, në sistemin e pakësimit të shkarkimeve, në lëndën djegëse, lëndët e para dhe materialet ndihmëse, produktet ose gjenerimin e mbetjeve, në menaxhimin e instalimit dhe kontrollit, mund të kryhen vetëm pas një kërkesë paraprake me shkrim dhe miratimit me shkrim nga autoriteti kompetent.
- 1.4. Kjo Leje jepet me qëllim parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes në përputhje me Ligjin Nr. 10431, datë 09.06.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit" dhe legjislacionin mjedisor në fuqi dhe nuk e përjashton mbajtësin e kësaj Leje nga detyrimet që rrjedhin nga ligjet e tjera në fuqi.
- 1.5. Instalimi për të cilin është dhënë kjo Leje nuk duhet të vihet në punë derisa të jenë marrë masat e mëposhtme dhe AKM si autoriteti kompetent të jetë njoftuar me shkrim për këtë.



- 1.5.17. Të jenë marrë të gjitha masat e nevojshme për kryerjen e punimeve me argjaturë mbrojtëse dhe rrjeta teli, për të shmangur rrëshqitjen e gurëve dhe dherave nga punimet që do të kryhen për shfrytëzimin e objektit mineral.
- 1.5.18. Të jenë marrë të gjitha masat e nevojshme për marrjen e lejeve, licencave dhe autorizimeve të kërkuara sipas legjislacionit në fuqi.
- 1.5.19. Të jenë marrë të gjitha masat e nevojshme për mbulimin e mjeteve të transportit dhe pastrimin e automjeteve të shfrytëzimit dhe transportit të mineralit.
- 1.5.20. Të jenë marrë të gjitha masat e nevojshme për kontrollin periodik të kushteve teknike të mjeteve të punës për të evituar, parandaluar ndotjen në mjedis nga keqfunksionimi i tyre.
- 1.5.21. Të jenë marrë të gjitha masat e nevojshme për menaxhimin e integruar të mbetjeve që gjenerohen nga instalimet.
- 1.5.22. Të jenë marrë të gjitha masat e nevojshme për mbrojtjen e punonjësve dhe banorëve të zonës përreth nga zhurmat e gjeneruara nga instalimet.
- 1.5.23. Të jenë marrë të gjitha masat e nevojshme për rehabilitimin e objektit mineral.
- 1.5.24. Të jenë marrë të gjitha masat e nevojshme që në asnjë rast nuk duhet të shfrytëzohen burimet ujore sipërfaqësore dhe nëntoksore, nese subjekti nuk ka leje shfrytëzimi nga autoritetet kompetente.
- 1.6. Në këtë Leje, vendndodhje nënkupton zonën e përcaktuar nga koordinatat e mëposhtme. Veprimtaritë e autorizuar sipas kushtit 1.1 nuk duhet të shtrihen përtej vendndodhjes, që është zona e përcaktuar nga koordinatat e mëposhtme.

PIKAT	X	Y	PIKAT	X	Y
1	45 44 590	44 63 570	20	45 42 641	44 63 015
2	45 44 525	44 63 460	21	45 42 445	44 62 858
3	45 44 607	44 63 405	22	45 42 400	44 62 858
4	45 44 700	44 63 300	23	45 42 398	44 63 004
5	45 44 700	44 63 220	24	45 42 100	44 62 968
6	45 44 100	44 63 000	25	45 42 100	44 62 700
7	45 43 795	44 63 116	26	45 42 400	44 62 843
8	45 43 795	44 63 181	27	45 42 757	44 62 944
9	45 43 725	44 63 181	28	45 42 793	44 63 025
10	45 43 725	44 63 116	29	45 43 350	44 63 130
11	45 43 350	44 63 144	30	45 43 725	44 63 096
12	45 43 084	44 63 086	31	45 43 795	44 63 096
13	45 43 113	44 63 160	32	45 44 100	44 62 980
14	45 42 954	44 63 181	33	45 44 700	44 63 200
15	45 42 892	44 63 159	34	45 44 800	44 63 200
16	45 43 074	44 63 085	35	45 44 800	44 63 300
17	45 42 793	44 63 040	36	45 44 720	44 63 300
18	45 42 756	44 63 111	37	45 44 625	44 63 395
19	45 42 660	44 63 077	38	45 44 695	44 63 500



2.7. Trajnimi

2.7.1. Mbjtësi i Lejes duhet të hartojë procedurat për identifikimin e nevojave për trajnim dhe duhet të zhvillojë trajnimet e duhura për të gjithë punonjësit, puna e të cilëve mund të ketë ndikime të rëndësishme në mjedis. Të dhënat dhe dokumentacioni i trajnimeve i vihen në dispozicion inspektorëve.

2.7.2. Punonjësit që kryejnë një detyrë specifike duhet të kenë arsim, trajnimin dhe përvojën të përshtatshme me natyrën e punës.

2.8. Përgjegjësia

2.8.1. Operatori duhet të sigurojë praninë e një personi përgjegjës në çdo kohë gjatë operimit të instalimit. Personi përgjegjës duhet të jetë i autorizuar dhe i disponueshëm për t'u takuar me persona të autorizuar nga Ministria ose inspektorati.

2.9. Komunikimi

2.9.1. Operatori duhet të hartojë një procedurë për t'i mundësuar publikut marrjen e informacionit lidhur me performancat mjedisore në çdo kohë. Kjo procedurë duhet t'i paraqitet autoritetit kompetent për miratim së bashku me dokumentacionin e Lejes.

2.9.2. Operatori duhet të paraqesë një Raport Vjetor të Mjedisit tek autoriteti kompetent çdo vit kalendarik. Ky raport, duhet të përfshijë minimalisht informacionin e specifikuar në Tabelën 2.9.1 më poshtë (Përmbajtja e Raportit të Mjedisit).

TABELA 2.9.1 – Përmbajtja e Raportit Vjetor të Mjedisit
Programi i Menaxhimit të Mjedisit– raport.
Regjistri i shkarkimit dhe transferimit të të ndotjes– raporti për vitin paraardhës.
Regjistri i shkarkimit dhe transferimit të të ndotjes– propozimi për vitin ushtrimor aktual.
Raport përmbledhës mbi rezultatet për monitorimin e zhurmës.
Përshkrim i monitorimit të mjedisit.
Përshkrim i monitorimit të zhurmës.
Përshkrim i incidenteve/aksidenteve.
Raporti për testimin e depozitave dhe tubacioneve.
Raport përmbledhës për auditimin e efikasitetit të energjisë, përfshirë raportin e djegies të secilit <i>bojleri</i> në instalim, të kryer nga një person/laborator i autorizuar/certifikuar.



3.4.4.Çfarëdolloj tubi hyrje ose dalje, valvule, tubat e daljes dhe matësit mbahen brenda zonës së argjinaturës/rrethuar.

3.4.5.Të gjitha argjinaturat/ rrethimet duhet të testohen për dëmtime dhe mundësi e depërtimit të ujit të paktën çdo tre vjet.

3.4.6.Operatori duhet të ketë sasi të mjaftueshme të përthithësit në vendndodhje , i cili do të përthithë çdo derdhje në instalim. Përthithësi, pas përdorimit duhet të asgjësohet në mënyrë të përshtatshme me tipin e materialit përthithës.

3.4.7. Operatori duhet të kryejë një vlerësim të rrezikut në mënyrë që të përcaktojë nëse është e nevojshme të mbahet uji i përdorur për shuarjen e një zjarrit përpara paraqitjes së kërkesës për Leje.

3.4.8.Nëse përcaktohet që risku ekziston, operatori përgatit një Program për Menaxhimin e Riskut, i cili duhet t'i paraqitet autoritetit kompetent për miratim. Programi zbatohet plotësisht brenda 3 muajve nga marrja e Lejes.

3.5 Nuk do të ketë mbetje të ndërtimit brenda instalimit dhe rrugët duhet të mirëmbahen në mënyrë që të mos shkaktohet gjenerim i pluhurave.

3.6. Të gjithë transportuesit shirit në vend të hapur si dhe ato në ambientet e brendshme me shpejtësi të barabartë ose më të madhe se 3 m/s do të mbyllen nga sipër.

KUSHTI 4 – PLANI I PËRPUTHSHMËRISË DHE AFATET KOHORE

Operatori duhet të zbatojë Planin e Përputhshmërisë siç përcaktohet në Tabelën 4.1.1. Përbajtja e Planit të Përputhshmërisë dhe afatet kohore të zbatimit janë paraqitur në tabelën më poshtë:

TABELA 4.1.1 – Plan i Përputhshmërisë						
Kushti Ref.	Veprimtaria e pajtueshmërisë	Kostot e investimit (EURO)	Fillimi i veprimtarisë (date)	Fundi i veprimtarisë (datë)	Rezultatet e veprimtarisë	Metoda e kontrollit
2.1	Përmirësimi i instalimit					
	Mirëmbajtje e instalimeve, pajisjeve dhe makinerive					
	Instalimi i rrjetave dhe sprucatorëve për kapjen e pluhurave					
	Grumbullimin e ujrave të karrierës, trajtimin dhe më pas shkarkimin e tyre					



- c) Asnjë vlerë mesatare për 30 minuta nuk do të tejkalojë vlerën kufi të shkarkimit më shumë se dy herë.

5.1.2. Monitorim jo i vazhdueshëm:

